



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 7, datë 10.07.2020

“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 dhe të pikës 6 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pika 62 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“62. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.”.

Neni 2

Në pikën 70 shtohen shkronja “c” dhe “d” me përmbajtjen si vijon:

“c) që dosjet e kandidatëve të jenë të plota dhe në kopje të mjaftueshme për t’u shpërndarë tek organet e emërtesës; dhe

d) mënyrën e përcjelljes së listës përfundimtare organeve të emërtesës”.

Neni 3

Në pikën 75, pas shprehjes “renditjes së kandidatëve”, shtohet shprehja “mënyra e përcjelljes së tyre organeve të emërtesës”.

Neni 4

Në pikën 76, shprehja “Menjëherë” zëvendësohet me shprehjen “Brenda dy ditëve pune”.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore Tusha